

KONTRATË TRANSFERIMI KUOTASH

(DHURIM)

Sot në datën 12 Gusht 2024, në Korçë nënshkruhet kjo kontratë transferimi për dhurim kuotash:

Palët kontraktuese:

Pala DHURUESE

Z. Astrit Isa, lindur ne Ersekë në datën 22.04.1962, me dokument identifikimi nr. 035117578, ID G20422006R, banues në Elbasan, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar,që më poshtë do të referohet si palë dhuruese.

Pala PRANUESE

Z. Engjëll Isa, lindur ne Ersekë ne datën 25.12.1963, me dokument identifikimi nr. 034275712, ID G31225047T banues në Elbasan, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar,që më poshtë do të referohet si palë përfituese.

Të cilët shprehën vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë për të përpiluar dhe nënshkruar kontratën e transferimit të kuotave të kapitalit themeltar si më poshtë:

BAZA LIGJORE

Neni 761 KC

Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat kjo i pranon. Nuk përbën dhurim heqja dorë nga një e drejtë para se të fitohet ajo, ose heqja dorë nga trashëgimi.

Neni 764 KC

Dhurimi i sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt publik dhe të regjistrohet, përndryshe është i pavlefshëm. Pranimi mund të bëhet me po atë akt, ose me akt të mëvonshëm. Në këtë rast dhurimi quhet i përfunduar nga momenti kur akti i pranimit i është njoftuar dhuruesit.

Neni 9 i Statutit te Shoqërisë "LARTI" Shpk

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'ju transferohen personave të tretë, që nuk bëjnë pjeseë në Shoqëri. Në këtë rast transferimi, duhet të jetë i miratuar nga ortakët, në kushtet e shumicës së kërkuar, për ndryshimet në statut (shumica që përbën $\frac{3}{4}$ e kapitalit themeltar).

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Pala dhuruese është ortak i shoqërisë “LARTI” Shpk e regjistruar ne QKB dhe organet tatimore me NIPT J94316024A.

Struktura e pronësisë të kuotave të kapitalit të shoqërisë “LARTI” shpk është si më poshtë:

- **Astrit Isa** zotërues i 50% të kapitalit, ose 500 kuota, me një vlerë kapitali gjithësej 480,000,000 lekë.
- **Luan Larti** zotërues i 50% të kapitalit, ose 500 kuota, me një vlerë kapitali gjithësej 480,000,000 lekë.

OBJEKTI I KONTRATËS

Pala dhuruese, Astrit Isa, i dhuron me vullnet të lirë, palës pranuese 25% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë “LARTI” Shpk, të barabartë me 250 kuota, me vlerë gjithësej 240,000,000 lekë.

Pala pranuese, Engjëll Isa, me vullnet të lirë dhe të plotë, pranon nga pala dhuruese, 25% te kuotave që ajo (pala dhuruese) zotëron në kapitalin themeltar të Shoqërisë “LARTI” Shpk, të barabartë me 250 kuota, me vlerë totale 240,000,000 lekë,

TRANSFERIMI I PRONËSISË

Me nënshkrimin e kontratës së transferimit të kuotave të cituara më lart, pala dhuruese zhvishet nga 25% e kapitalit të barabartë me 240,000,000 lekë që zotëron në shoqëri, dhe pala pranuese bëhet zotëruese e kuotave prej 25% me vlerë 240,000,000 leke te kapitalit të shoqërisë “LARTI” Shpk.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, ortakë të shoqërisë “LARTI” Shpk janë:

1. **Astri Isa**, zotërues i 25% të kapitalit, ose 250 kuota me vlerë 960,000 lekë secila, dhe me vlerë totale 240,000,000 lekë.
2. **Engjëll Isa**, zotërues i 25% të kapitalit, ose 250 kuota me vlerë 960,000 secila, dhe me vlerë totale 240,000,000 lekë.
3. **Luan Larti**, zotërues i 50% të kapitalit, ose 500 kuota me vlerë 960,000 secila, dhe me vlerë totale 480,000,000 lekë.

Pala pranuese, merr përsipër te gjitha të drejtat dhe detyrimet e Shoqërise, sipas përqindjes se pjesëmarrjes së kapitalit që gëzon në shoqëri, që nga moment i nënshkrimit të kontratës e në vijim.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Kontrata u përpilua në Katër kopje me fuqi të barabartë, njëra prej të cilave depozitohet ne QKB, për tu bërë ndryshimet përkatëse në Regjistrin Tregtar, dhe ne Regjistrin e Pronareve Perfitues.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA DHURUESE

Astrit ISA



PALA PRANUESE

Engjëll ISA

